

VENDIM
Nr. 11, datë 15.1.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 191, DATË 9.3.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE
SHTETËRORE PËR SISTEMIN E SHËRBIMEVE TË PUNËSIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 191, datë 9.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e shërbimeve të punësimit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive është administratori i vetëm i SSHP-së. AKPA-ja, në mbështetje të funksionimit të SSHP-së, krijon e administron platformën e bashkëpunimit “puna.gov.al”, ku realizohen procedurat e shërbimit të punësimit ndaj punëkërkuësve dhe punëdhënësve.”;

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Të dhënat parësore konsiderohen të dhënat, për:

a) Punëkërkuësit:

i. punëkërkuës i papunë;

ii. punëkërkuës i punësuar;

iii. përfitues i shërbimeve të punësimit;

iv. përfitues nga programe të nxitjes së punësimit;

v. përfitues i kurseve të formimit profesional publik;

vi. përfitues nga programi i pagesës së papunësisë.

b) punëdhënësit:

i. shërbime që i ofrohen;

ii. përfitues nga programet;

c) vendet e lira të punës në sektorin privat.”;

c) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Të dhënat dytësore konsiderohen të dhënat, për:

a) Punëkërkuësin:

i. të dhëna personale nga baza e të dhënave shtetërore të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, administruar nga DPGJC-ja;

ii. të dhëna mbi punësimin nga baza e të dhënave shtetërore të tatimit elektronik, administruar nga DPT-ja;

iii. të dhëna nga trajtimi i tij me ndihmë ekonomike nga baza e të dhënave shtetërore të ndihmës ekonomike, administruar nga Shërbimi Social Shtetëror;

iv. të dhëna mbi leje drejtimi nga baza e të dhënave shtetërore të Regjistrit Kombëtar të Personave të Aftësuar për Drejtimin e Mjeteve, administruar nga DPSHTRR-ja;

v. të dhëna mbi kontributet e sigurimeve shoqërore nga baza e të dhënave shtetërore të sistemit elektronik për menaxhimin e kontributeve, administruar nga ISSH-ja.

b) Punëdhënësin:

i. të dhënat e subjektit tregtar nga baza e të dhënave shtetërore të Regjistrit Tregtar, administruar nga QKB-ja;

ii. të dhënat e subjektit të tatueshëm nga baza e të dhënave shtetërore të tatimit elektronik, administruar nga DPT-ja.

c) Vendet e lira të punës të shpallura nga punëdhënësit e sektorit shtetëror.”;

ç) Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Në kuptim të këtij vendimi, në sektorin shtetëror përfshihen institucionet/entet dhe sistemet e administratës shtetërore, njësitë e fondeve speciale, ndërmarrjet shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror dhe shoqëritë aksionare shtetërore, që kanë detyrimin:

a) të publikojnë në platformën “puna.gov.al” të gjitha vendet e lira të punës, brenda një afati kohor jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara mbylljes së afatit për aplikim;

b) të raportojnë në platformën “puna.gov.al” të dhëna për numrin e aplikantëve dhe rezultatin përfundimtar të procesit të rekrutimit, brenda një afati jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike nga përfundimi i procesit.”;

d) Fjalë hyrëse dhe shkronja “a”, e pikës 8, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“8. Baza e të dhënave të AKPA-së shkëmben informacion me institucione të sektorit shtetëror, sipas legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore, lidhur me shërbimet që ofron. Bazuar në legjislacionin në fuqi:

a) institucionet, nga të cilat SSHP-ja merr të dhëna parësore, janë:

i. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

ii. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

iii. Shërbimi Social Shtetëror;

iv. Qendra Kombëtare e Biznesit;

v. Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

vi. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;

vii. Departamenti i Administratës Publike.”;

dh) Pas pikës 8 shtohet pika 8/1, me këtë përmbajtje:

“8/1. Përpunimi i të dhënave personale në Sistemin e Shërbimeve të Punësimit (SSHP) kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Palët transmetojnë vetëm të dhënat personale të domosdoshme për realizimin e qëllimit të bazës së të dhënave në fushën e punësimit, duke zbatuar masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel të përshtatshëm sigurie.”;

e) Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Nivelet e aksesit të çdo përdoruesi janë:

a) nivel administrator;

b) nivel modifikues;

c) nivel lexues;

ç) nivel përdorues i jashtëm.

Rolet e nivelit të aksesit dhe të të drejtave të çdo përdoruesi përcaktohen në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore për Sistemin e Shërbimeve të Punësimit”, që miratohet nga drejtori i përgjithshëm i AKPA-së.”;

ë) Kudo në tekst, emërtesa “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” zëvendësohet me “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”;

f) Kudo në tekst, emërtesa “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit” zëvendësohet me “Drejtoria Qendrore e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, institucionet/entet dhe sistemet e administratës shtetërore, njësitë e fondeve speciale, ndërmarrjet shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror dhe shoqëritë aksionare shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama